



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 korrik 2013
Nr. ref.:RK434/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI27/13

Parashtruesi

Kadri Çitaku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, nr. 556/2011, të 28 shtatorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Kadri Çitaku nga fshati Gjurakoc, komuna e Istogut.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556/2011, i 28 shtatorit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 16 tetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Gjykata supozon në bazë të dokumenteve të paraqitura se objekt i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556/2011 të 28 shtatorit 2012, me të cilin është aprovuar Aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS)– Departamentit të Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejshëm: DAP), nr. 5097359 të 15 marsit 2011, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit për t'iu njohur e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.
4. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar formularin e kërkesës të cilin ia ka dërguar Gjykata Kushtetuese nëpërmjet njoftimit nr. ref. 713/13/rl të 4 prillit 2013, e as nuk i ka cekur se cilat nene të Kushtetutës dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur parashtruesit të kërkesës.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 i 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7. dhe 22.8. të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Parashtruesi i kërkesës më 4 mars 2013, insistoi që Gjykata Kushtetuese të regjistrojë dhe të pranojë dokumentacionin të cilin parashtruesi e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), edhe pse nga këshilltari ligjor është udhëzuar se duhet të plotësojë formularin e kërkesës dhe të tregojë se cilat nene të Kushtetutës dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur parashtruesit të kërkesës.
7. Më 4 prill 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës se Gjykata e ka regjistruar lëndën, ia dorëzoi parashtruesit formularin e kërkesës me kërkesë që ta plotësojë dhe ta dorëzojë në Gjykatë.
8. Më 14 maj 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Supreme ta dorëzojë dokumentacion shtesë së bashku me dëshmitë se kur parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556 / 2011 të 28 shtatorit 2012.
9. Më 17 maj 2013, Gjykata Supreme të Kosovës e ka dorëzuar fletëkthesën në Gjykatën Kushtetuese, e cila dëshmon se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556/2011 të 28 shtatorit 2012, më 16 tetor 2012.

10. Më 14 qershor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (Kryesues), Almiro Rodrigues dhe Prof. Dr. Ivan Čukalović, i ka rekomanduar Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 4 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti te MPMS-DAP kërkesë për njohjen e të drejtës të parashtruesit të kërkesës për pension për persona me aftësi të kufizuara. MPMS-DAP me Vendimin nr. 5097359 të 4 shtatorit 2010, e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit, sepse nuk i plotëson kriteret për t'iu njohur e drejta në pension për aftësi të kufizuara.
12. Kundër Vendimit të MPMS-DAP nr. 5097359 të 4 shtatorit 2010, parashtruesi i kërkesës më 6 janar 2011, paraqiti ankesë në MPMS-DAP – Këshillit për ankesa dhe pensione për persona me aftësi të kufizuara, i cili, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, me Aktvendimin nr. 5097359 të 15 marsit 2011 e ka refuzuar ankesën e 6 janarit 2011, për njohjen e të drejtës për pension për persona me aftësi kufizuara, si të pabazuar dhe e ka vërtetuar vendimin e Komisionit mjekësor të shkallës së parë, si plotësisht të bazuar në përputhje me Ligjin nr. 2003/23.
13. Kundër Aktvendimit të MPMS-DAP– Këshillit për ankesa dhe pensione për persona me aftësi të kufizuara nr. 5097359 të 15 marsit 2011, parashtruesi i kërkesës ushtron padi në Gjykatën Supreme të Kosovës.
14. Duke vendosur sipas padisë së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin A. nr. 556/2011, të 28 shtatorit 2012, e hedh poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës me këtë arsyetim:

“Në procedurën sipas ankesës, organi i paditur siguroi konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të të paditurës nr. 5097359, dt. 25.02.2011, për vlerësimin e Komisionit mjekësor të personave me aftësi të kufizuara, organit të faktit, i cili përputhet me konstatimin dhe mendimin e komisioneve mjekësore të dhëna më parë, prandaj edhe me vendimin e kundërshtuar e refuzoi si të pabazuar ankesën e paditësit dhe vërtetoi vendimin e atakuar.”

“Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore të autorizuara me ligj, kanë vërtetuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, Gjykata konstaton se organet administrative kanë zbatuar drejt dispozitën e nenit 3 të Ligjit të cekur më lart, në bazë të të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditësit që t'i njihet e drejta për pension invalidor.”

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës ia ka dorëzuar Gjykatës Kushtetuese 49 faqe të dokumenteve të ndryshme, numri më i madh i të cilave ka të bëjë me dokumentacionin në lidhje me realizimin e së drejtës për pension për persona me aftësi të kufizuara.

16. Parashtruesi i kërkesës pavarësisht nga njoftimi me shkrim nr. ref. 713/13/rl të 4 prillit 2013 të Gjykatës Kushtetuese, nuk e ka plotësuar formularin dhe as që i ka cekur se cilat nene të Kushtetutës dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur parashtruesit të kërkesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe Ligj.
18. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 49 (Afatet) të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”.

19. Gjykata vëren se nga dokumentacioni shtesë të cilin e ka dorëzuar Gjykata Supreme e Kosovës, është konstatuar se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556/2011 të 28 shtatorit 2012, më 16 tetor 2012, kur parashtruesi i kërkesës e ka nënshkruar fletëkthesën.
20. Vendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 16 tetor 2012, ndërsa parashtruesi i kërkesës më 4 mars 2013 e paraqiti parashtrësën në Sekretariatit e Gjykatës Kushtetuese.
21. Nga kjo rrjedh se kërkesa nuk është e pranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 49 (Afatet) të Ligjit dhe rregullit 36 (1b) të Rregullores së punës, i cili parasheh: *„Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit parashtruesit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv“.*


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Dr. sc. Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani